

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SHIJAK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Shijak me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e asetëve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, organizimin dhe funksionimin e njësisë së auditimit, etj.”. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 87, datë 11.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 149/6, datë 11.6.2012, dërguar z. **Indrit BUKA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa, që hartimi i planit të buxhetit të shoqërohet me një relacion shpjegues, ku të jenë analizuar hollësisht, objektivat që do të realizohen në kuadër të politikave të zhvillimit, rritja e të ardhurave për të krijuar mundësi më të mëdha për financimin e projekteve të ndryshme, rritja e shpenzimeve për investime duke ulur shpenzimet operative të cilat duhet të planifikohen të detajuara, etj.

Vazhdimisht

2. Të merren masa për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara si: Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” me vlerë 13,818,965 lekë; Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” me vlerë 108,508,870 lekë; Llogaria 213 “Rrugë, mjete, vepra ujore” me vlerë 222,360,883 lekë; Llogaria 214 “Instalime, makineri pajisje e vegla pune” me vlerë 17,500,897 lekë, të hapen kartela për secilin ku të pasqyrohet origjina e këtyre mjeteve, viti i krijimit të tyre, vlera fillestare, përqindja e amortizimit (për ato që llogaritet amortizim), etj.

Menjëherë

3. Të merren masa, që të bëhen hyrje në magazinë e të kontabilizohen në ditarin përkatës të magazinave vlera prej 1,853,000 lekë për 4 studime e projektme të paguara nga Bashkia në vitet 2010 e 2011.

Menjëherë

4. Të merren masa, që në dosjet e biznesit të vogël të administrohet Vendimi i QKR-së, në zbatim të neneve 75, 77 dhe 78 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Menjëherë

5. Të merren masa, që Zyra e Taksave Vendore, të hartojë planin vjetor për ushtrimin e kontroleve në drejtimet e përcaktuara në pikën 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

Menjëherë

6. Të merren masa, që të analizohet lista e detyrimeve të papaguara për tatime dhe tarifa për 29 subjekte në shumën prej 834,350 lekë, të kontabilizohet dhe të fillojë detyrimi i arkëtimit.

Menjëherë

7. Të merren masa, që të planifikohet për vitin 2012 e në vazhdim, tarifa e pastrimit ndaj Enteve Shtetërore në juridiksion të Bashkisë Shijak si Zyra e Punësimit, Komisarati i Policisë, Posta, Spitali etj.

Menjëherë

8. Të merren masa që të mos jepen leje ndërtimi, pa përfunduar më parë plani territorial vendor nga autoritetet përkatëse të planifikimit, i cili të përmbush standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në funksion të tij.

Menjëherë

9. Të merren masa për të shoqëruar aktin e kolaudimit të rrjetit të ujësjellësit, me projektin e kanalizimeve të ujësjellësit dhe aktin e kolaudimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, me projektin e KUZ-ve, në objektet ndërtimore, për të cilat lëshohet leja e shfrytëzimit, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshimet e mëvonshme, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

10. Të merren masa për ushtrimin e kontrolleve nga INU në Bashki, në lidhje me vendosjen e mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

11. Të merren masa nga INU në Bashki, për të detyruar zbatuesit e punimeve të njoftojnë zyrtarisht fillimin e punimeve, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

12. Të merren masa nga INU në Bashki, për të kërkuar subjekteve të ndërtimit, planin e organizimit të punimeve në objekt, mbajtja e procesverbalit për gjendjen e masave të sigurimit teknik të punimeve të ndërtimit dhe pajisjen me mjete për mbrojtjen e jetës së punëtorëve, si pjesë e dokumentacionit të dosjes teknike, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshimet e mëvonshme, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

13. Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor, për të dërguar në Agjencinë e Prokurimeve Publike, regjistrin e parashikimit dhe realizimit të prokurimit publik, në zbatim të nenit 12 pika 4, nenit 13 pika 2 shkronja “g”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” me ndryshimet e mëvonshme dhe Kreut I pika 3, shkronja “b” e “d”, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

14. Të merren masa nga Policia Bashkiake dhe Zyra e Taksave Vendore, që të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë ndërmjet tyre, ndaj të gjitha subjekteve që kryejnë aktivitet të pa regjistruar, si dhe ndaj atyre që nuk kanë derdhur detyrimet vendore, gjobat etj.

Vazhdimisht

15. Të merren masa nga Policia Bashkiake dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë, të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë për çdo rast në evidentimin, parandalimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi brenda territorit administrativ të Bashkisë, si dhe të zbatojnë procedurat ligjore për prishjen e objekteve ndërtimore të ngritura pa leje ndërtimi, apo në kundërshtim me atë të miratuar.

Vazhdimisht

16. Të merren masa që të ngrihet si strukturë e veçantë Njësia e Auditit të Brendshëm, duke rekrutuar specialistë të kualifikuar në këtë fushë, në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 2, 3, 4, 5, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 66, pika 6 dhe neni 68.

Menjëherë

17. Të mos jepet leja e përdorimit pa u likuiduar shuma prej 259,150 lekë, nga investitori [REDAKTUAR], për mospagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksës për financimin e studimeve urbanistike, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, shumë e cila është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë.

Brenda datës 30.09.2012

18. Kryetari i Bashkisë të ndërpresë marrëdhëniet e punës të [REDAKTUAR], me detyrë Nënkryetar i Bashkisë, pasi ka plotësuar moshën për pension pleqërie, në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 478, datë 16.6.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”.

Menjëherë

B. MASAT PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në kreu VI, pika 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kontratën datë 30.3.2010 të lidhur ndërmjet Bashkisë Shijak dhe shoqërisë [REDAKTUAR] Shijak, për 1 rast në vlerën 251,568 lekë, të nxirret urdhri për shpërbllim dëmi, të kryen kontabilizimet dhe të bëhet ndalesa, nga shoqëria [REDAKTUAR] Shijak, për punime të pakryera në objektin “Rikonstruksion kopshti nr. 2”.

Brenda datës 30.09.2012

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkohet të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga shërbimi civil” neni 25, pika 3, germa d

- Për Zj. [REDAKTUAR], me detyrë përgjegjëse e Seksionit të Urbanistikës.

- Për moszbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshimet e mëvonshme, neni 7, neni 12, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” me ndryshimet e mëvonshme, neni 4, neni 22/1, neni 35, neni 39, neni 50, neni 52, neni 54, lidhur me hartimin e Studimeve Urbanistike Pjesore, mbajtjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të detyrueshëm në lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe lejeve të shfrytëzimit.

- Për të meta e mangësi në dokumentacionin teknik të lejeve të ndërtimit, të planeve të veprimit, të Studimeve Urbanistike Pjesore, në dokumentacionin për shqyrtim dhe miratim në KRRT, në mbajtjen e akteve të kontrollit për fazat e realizimit të punimeve, në respektimin e afateve të vlefshmërisë të përcaktuara në lejet e ndërtimit, në caktimin e mbikëqyrësit të punimeve dhe në

hartimin e firmosjen e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

- Për Zj. ■ me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Taksave e Tarifave.
- Për mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 9, 15 dhe 20, lidhur me mos kryerjen e asnjë kontrolli në subjekte, për mbajtjen e librit të shitjeve, librit të blerjeve, nivelit xhiros, etj.
- Për mos zbatim të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 75, 77 dhe 78 dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, lidhur me administrimin e Vendimeve të QKR-së në dosjet e biznesit të vogël

“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25 pika 3, gërma b

- Për Znj. ■ me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës.
- Për mos zbatim të neneve 4, 12, 16 dhe 23 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, lidhur me mos kontabilizimin aktiveve e qëndrueshme të trupëzuara.
- Për mos zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1985 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" dhe të neneve 4, 12, 16 dhe 23 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, lidhur me mos bërjen hyrje në magazinë dhe kontabilizimin në ditarin përkatës të magazinave për vlerën prej 1,853,000 lekë për 4 studime e projekte të paguara nga Bashkia në vitet 2010 e 2011.

2. Mbështetur në nenet 37 e 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe neni 8 të kontratës të punës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhje e kontratës së punës”

- Për Zj. ■ me detyrë inspektore e Sektorit të Taksave e Tarifave.
- Për mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 9, 15 dhe 20, lidhur me mos kryerjen e asnjë kontrolli në subjekte, për mbajtjen e librit të shitjeve, librit të blerjeve, nivelit xhiros, etj.
- Për mos zbatim të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 75, 77 dhe 78 dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, lidhur me administrimin e Vendimeve të QKR-së në dosjet e biznesit të vogël.
- Për Zj. ■ me detyrë inspektore e Sektorit të Taksave e Tarifave.
- Për mos zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 9, 15 dhe 20, lidhur me mos kryerjen e asnjë kontrolli në subjekte, për mbajtjen e librit të shitjeve, librit të blerjeve, nivelit xhiros, etj.
- Për mos zbatim të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, neni 75, 77 dhe 78 dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, lidhur me administrimin e Vendimeve të QKR-së në dosjet e biznesit të vogël.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Iliazi, Jonel Nasto dhe Gjergji Dhima. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb

Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT